

JO NISMËS SË RREZIKSHME PËR «ZBATIM (TË DËBIMIT)»

AUTOMATIZMI PËRBUZËS I SË DREJTËS SË QËNDRIMIT TË MË SHUMË SE 2 MILLION NJERËZVE

Nisma për «zbatim (të dëbimit)» kërcënon të drejtën e qëndrimit të më shumë se 2 milion njerëzve që jetojnë dhe punojnë në Zvicër, të cilët nuk kanë marrë ende shtetësinë zvicerane. Ata do të dëbohen automatikisht, pa marrë parasysh rrethanat, edhe në rast se janë dënuar për një kundrvajtje të vogël – megjithëse kanë lindur e janë rritur në Zvicër. Kjo nismë prek edhe gjenetarën e dytë. Legjislacioni që është votuar në parlament lidhur me nismën e zbatimit për dëbim, parashikon një klauzolë saktësimi për raste të tilla. Pikërisht këtë klauzolë e hedh poshtë nisma e re e zbatimit për dëbim.

MASHTRIM I PABESË

Emërtimi nisma për «zbatim» sugjeron favorizimin e hyrjes në fuqi të asaj që është vendosur kohë më parë. Në fakt, këtu kemi të bëjmë me një mashtrim pasi nisma për «zbatim (të dëbimit)» dhe katalogu i veprave penale që korrespondojnë me të shkon edhe më tej se sa ajo që ka vendosur shumica e votuesve me pranimin e nismës për dëbim. Nisma e re nuk vë në zbatim iniciativën për dëbimin; ajo e rëndon konsiderueshëm atë.

ANASHKALIM I RREZIKSHËM I SHTETIT TË SË DREJTËS

Norma kushtetuese e propozuar shkel të drejtat themelore që janë mishëruar në Kushtetutën tonë, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut (CEDH) dhe Marrëveshjen për Qarkullimin e lirë të personave (ALCP). Duke kërkuar të vendosë ligjin, ajo i privon të gjitha gjykatat nga liria e gjykimit dhe diskrecioni mbasi teksti i nismës shkel principin e ndarjes së pushteteve në dy aspekte. Pranimi i kësaj nisme do të përbënte një shkelje të rëndë të sistemit të drejtësisë dhe do të kishte pasoja të paparashikueshme për sistemin ligjor, sigurinë juridike dhe sistemit tonë politik.

MARDHËNIET ME BASHKIMIN EUROPIAN VIHEN NË RREZIK

Sipas Këshillit federal, në rast të ripranimit të kësaj nisme, më tepër se 10000 persona do të dëbohen automatikisht nga Zvicra – pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat e tyre. Me këtë akt, Zvicra do të shkelte me mijëra herë Marrëveshjen për Qarkullimin e lirë të personave. Aproximi i nismës për «zbatim (të dëbimit)» do shtonte një artikull të ri në Kushtetutën zvicerane, i cili do të shkatërronte mardhëniet e mira me Bashkimin Europian.



«Nëpërmjet zbatimit të kësaj iniciative do të shkaktohej një ortek shkatërrues që do të godiste shumë njerëz të pambrojtur. Shteti ynë ligjor do të minohej dhe do të kërcënonte pashmangshëm të drejtën e qëndrimit të mijëra njerëzve në Zvicër.»

Osman Osmani, nën/kryetar i Migrantëve të Partisë Socialdemokrate të Zvicrës (SP/PS); sekretar nacional për migracion në Unia; deputet në Parlamentin e Kantonit Schaffhausen



«Kjo nismë do të kishte pasoja brutale për njerëzit me të cilët jetojmë së bashku për vite me radhë. Ajo është në kundërshtim të hapur me të drejtat e njeriut. Ne kemi nevojë për një sinjal të qartë kundër çmendurisë për zbatim të detyrueshëm të SVP/UDC, e cila përndryshe drejton vendin në qorrsovak.»

Zari Dzaferi, deputet në Parlamentin e Kantonit Zug, kandidat për Qeverinë e Kantonit Zug, arsimtar në shkollën e mesme në Baar




«Një iniciativë e tillë është jashtëzakonisht e rëndë për individët e lindur dhe rritur në Zvicër, të cilët nuk e kanë marrë ende shtetësinë zvicerane : ata mund të dëbohen automatikisht nga Zvicra, pavarësisht nga rrethanat, qoftë edhe për një kundrvajtje të vogël!»

Edlira Dedja-Bytyqi, antare e Parlamentit dhe Presidente e Komisionit të Politikës Kulturore në Neuchâtel, pianiste dhe pedagoge


EMIGRANTËT, QOFSHIN GRA APO BURRA, KANË NJË INFLUENCË TË KONSIDERUESHME

Zvicra i ka dhënë shtetësinë vitet e fundit më shumë se një milion njerëzve. Rreth 880 000 zviceranë dhe zvicerane të moshës mbi 15 vjeç kanë një kombësi të dytë. Nëse gjithë këta njerëz me sfond migracioni marrin pjesë në votime, ata mund të përbëjnë shumicën. Një JO si kundërpërgjigje e iniciativës çnjerëzore për «zbatim (të dëbimit)» mund të bëhet e mundur vetëm nëse të gjithë marrin pjesë në votim!


SI TË VOTOJMË?




Hapni zarfin e transmetimit




Shkruani (JO) NON apo NEIN në fletën e votimit




Vendoseni fletën e votimit brënda zarfit anonim të votës dhe mbylleni atë



Firmoseni kartën e legjitimitetit që ndodhet brënda zarfit të transmetimit



Vendoseni zarfin anonim të votës së bashku me kartën e legjitimitetit brënda zarfit të transmetimit, duke e mbyllur përsëri atë



Dërgoni zarfin e transmetimit brënda datës 20 shkurt me anë të postës ose çoni votën tuaj deri më 24 shkurt në kutinë postare të Komunës

NE I THEMI JO NISMËS PËR «ZBATIM (TË DËBIMIT)»

Parti dhe organizata të shumta nga komunitete të ndryshme në Zvicër janë bashkuar për të luftuar së bashku kundër nismës çnjerëzore dhe të rrezikshme të «zbatimit (për dëbim)». Këto parti ose organizata vijnë nga komunitetet shqiptare, gjermane, arabe, spanjolle, franceze, italiane, kurde, portugeze, sërbe-slllovene-kroate-bosnjake, tamule dhe turke.

NE KEMI NEVOJË PËR MBËSHTETJEN TUAJ

Migrantët e Parisë Socialiste/Socialdemokrate luftojnë për barazinë e të gjithë emigrantëve, qoftë në fushën politike, ashtu si edhe në atë ekonomike, sociale apo kulturore. Ne kërkojmë pjesëmarrjen e barabartë të të gjithë emigrantëve, luftojmë kundër çdo lloj diskriminimi dhe bashkëpunojmë ngushtësisht me partitë dhe organizatat e komuniteteve të huaja. Antarësohuni në Partinë Socialiste të Migrantëve dhe mbështeteni këtë fushatë nëpërmjet një donacioni! Kontakti: www.pssuisse.ch/migrants (frëngjisht) www.spschweiz.ch/migranten (gjermanisht)

Kontakti: SP MigrantInnen, Postfach 7876, 3001 Bern, Telefon 031 329 69 69, info@spschweiz.ch, www.spschweiz.ch/migranten

PS Migrant-e-s, case postale 7876, 3001 Berne, telefoni: 031 329 69 69, info@pssuisse.ch, www.pssuisse.ch/migrants

Donacionet bëhen për:

– SP Schweiz, 3001 Bern, PC 30-28039-3, IBAN CH45 0900 0000 3002 8039 3, duke përmëndur «SP MigrantInnen, Kampagne Durchsetzungsinitiative»

– PS Suisse, 3001 Berne, PC 30-28039-3, IBAN CH45 0900 0000 3002 8039 3, duke përmëndur «PS Migrant-e-s, campagne mise en œuvre»

